



NR 2294/4 Prot  
DT 11.04.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë; Tel-Fax: 04-228485  
E-mail: [lmilo@klsh.org.al](mailto:lmilo@klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 182 / Prot.  
10

Tiranë, më 09 / 4 / 2019

SHKRESË PËRCJELLËSE

**Lënda:** Raporti Përfundimtar i Auditimit të Performancës,  
"PERFORMANCA E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES  
FINANCIARE"

**Drejtuar:** Z. Ervin KOÇI  
Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Tiranë

I nderuar z. Drejtor!

Në përfundim të auditimit me temë "Performanca e AMF", lutem gjeni bashkëlidhur raportin përfundimtar të auditimit dhe vendimin e Kryetarit të KLSH-së mbi të.

Duke Ju uruar punë të mbarë,

Në mungesë dhe me delegim

Bujar LESKAJ

Lindita MILO

K R Y E T A R

Zëvendës Kryetar



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë; Tel-Fax: 04-228485  
E-mail: [bleskaj@klsh.org.al](mailto:bleskaj@klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 782/19 Prot.

Tiranë, më 20/12/2018

**V E N D I M**

**Nr.228, Datë 20/12/2018**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**  
**"PERFORMANCA E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE"**

Në zbatim të Planit Vjetor Institucional 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas Programit të Auditimit nr. prot. 782/1, datë 15.10.2018, ndërmori auditimin me temë "PERFORMANCA E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE".

Ky auditim u programua për t'u ushtruar në subjektet: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Faza studimore e auditimit nisi më datë 28.06.2018 me shkresën njoftim-fillim auditimi, drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me nr. prot. 782, datë 28.06.2018. Për mbledhjen e informacionit të nevojshëm, grupi i auditimit ka realizuar intervista, konsultime me ekspertë, pyetësorë me publikun, raporte të subjekteve nën auditim, informacione të grupeve të interesit, etj.

Faza në terren e auditimit nisi më datë 15.10.2018 me programin e auditimit të sipërcituar, i cili iu përcoll edhe Autoritetit të Konkurrencës për ta përfshirë si institucion nën auditim dhe përfundoi më datë 25.05.2018.

Projekt-raporti i auditimit mori formë përfundimtare më datë 18.11.2018 dhe iu përcoll subjekteve nën auditim, përkatësisht me nr. prot. 782/3 dhe 782/4:

1. Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;
2. Autoritetit të Konkurrencës;

Në respektim të afatit 1-mujor, grupi i auditimit priti observacionet nga subjektet nën auditim. AMF përcolli komentet dhe shënimet me shkresën nr. prot. 782/6, datë 18.12.2018. Në takimin e ballafaqimit midis AMF-së dhe grupit të auditimit, AMF binte përgjithësisht dakord me gjetjet dhe rekomandimet e projekt-raportit, me përjashtim të disa formulimeve dhe konkluzioneve. Argumentet dhe kundër-argumentet e palëve u shterruan gjatë këtij takimi dhe grupi i auditimit, aty ku e gjetoi të arsyeshme, reflektoi përshtatjet dhe ndryshimet përkatëse në riformulim.

Si rezultat i mungesës së bashkëpunimit të Autoritetit të Konkurrencës me grupin e auditimit, nuk u arrit të konkludohej mbi kontributin që ky autoritet ka dhënë në mirë-funksionimin e tregut të sigurimeve, por kjo çështje do të ezaurohet në auditimin përkatës të performancës që do të realizohet brenda vitit 2019 në këtë institucion.



Në përfundim, pasi u njoha me raportin përfundimtar të auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standarteve dhe Kontrollit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja "c" të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit":

## KONKLUDOVA

Performanca e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare meriton një vëmendje maksimale dhe trajtim të vazhdueshëm duke marrë në konsideratë rëndësinë socio-ekonomike të tregut të sigurimeve tek qytetarët dhe rolin që luan AMF në rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtij tregu.

Tregu i sigurimeve në Shqipëri përballet me problematika të shumta të cilat kanë shkaktuar edhe jehonë të gjerë mediatike. Mospagesat e dëmeve nga Fondi i Kompensimit, luhatjet e çmimeve të primeve dhe aftësia e ulët paguese e kompanive të sigurimit janë disa nga faktorët më shqetësues.

Konteksti i Shqipërisë është ai i një tregu sigurimesh të vogël dhe të pazhvilluar në krahasim me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Përsa i përket vlerës së primeve të shkruara bruto, vendi ynë renditet i treti nga fundi me një vlerë prej 112 milionë euro, duke lënë pas vetëm Kosovën dhe Malin e Zi. Në lidhje me peshën që zënë primet e shkruara bruto në GDP, Shqipëria renditet e fundit me një peshë prej vetëm 1,04%. Primi i shkruar bruto për frymë në Shqipëri është 38,89 euro, tregues ky që përsëri e rendit Shqipërinë të fundit në listë.

Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe menaxhimi i Fondit të Kompensimit vazhdojnë prej vitesh të jenë në ngërç, duke u kthyer në problematikën më të madhe të tregut të sigurimeve. E gjithë kjo situatë ka arritur deri në këtë gjendje për shkak se Byroja nuk ka zbatuar detyrimet e saj për mbledhjen e kontributit vjetor për Fondin e Kompensimit nga shoqëritë e sigurimit dhe nuk ka lëshuar autorizime për pagesë për dosjet për të cilat ka përfunduar procesi i trajtimit. Byroja nuk ka pasur asnjë sistem raportimi, duke neglizhuar dhe zvarritur zbatimin e vendimeve të Bordit të AMF-së. Në këtë pikë, ndikim të madh ka edhe performanca e AMF-së, e cila duhet të zbatohet siç duhet kompetencat e saj në lidhje me mbikëqyrjen ndaj Byrosë.<sup>1</sup>

Subjektet që grupi auditues ka përfshirë në këtë auditim janë Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Peshën dhe fokusin më të madh të auditimit e ka patur AMF, në linjë edhe me temën e këtij auditimi. Gjithashtu, veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është e rëndësishme sa i përket sigurimit të një konkurrence të lirë dhe të ndershme midis operatorëve të sigurimit dhe ka impakt të gjerë te konsumatori shqiptar.


<sup>1</sup> AMF ka miratuar tradicionalisht vlerën e Fondit të Kompensimit që ka propozuar vetë Byroja pa ndërmarrë analiza të situatës, si dhe nuk ka kryer inspektime të mjaftueshme mbi saktësinë e raportimit dhe ecurinë e pagesave të bëra nga shoqëritë deri në vitin 2017.





Infografik 1/Burimi: Grupi i auditimit

Nëse shqyrtojmë kompanitë e sigurimeve dhe klasat që ato ofrojnë, do të vinim re se mbizotërojnë kompanitë që kryejnë vetëm sigurime Jo-Jetë (8) përkundrejt kompanive që ofrojnë sigurime Jetë (3) dhe atyre që i ofrojnë të dyja (2). Gjatë viteve 2015-2017, vlera e primeve të shkruara bruto ka ardhur në rritje, si për sigurimet Jetë, ashtu edhe për ato Jo-Jetë. Megjithatë, problem mbetet raporti i dëmeve të shlyera me primet e shkruara bruto, sidomos për sigurimet e Jo-Jetës, në periudhën nën auditim. Ky raport ka variuar nga 38,8% në 2015, në 29,7% në 2016 dhe 31,1% në 2017. Në vijim paraqitet infografiku i ecurisë së tregut të sigurimeve dhe disa statistika për periudhën nën auditim.



Infografik 2/Burimi: Grupi i auditimit

Ky auditim pati si objektiv matjen e performancës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me fokus në mënyrën e sjelljes së saj në tregun e sgrurimeve. Grupi auditues ka vlerësuar, kështu:

1. Efektivitetin e Autoritetit kah rregullimi dhe mbikëqyrja e tregut të sigurimeve për periudhën 2015-2017;
2. Besueshmërinë dhe mbrojtjen ndaj konsumatorëve në funksion të një tregu konkurses të sigurimeve, si dhe bashkëpunimin me Autoritetin e Konkurrencës;
3. Raportin me Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe funksionin mbikëqyrës ndaj saj.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivit në fazën studimore, analizimit dhe testimit të evidencave gjatë fazës analitike, grupi i auditimit arriti në këtë mesazh auditimi:

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për periudhën nën auditim 2015-2017, ka qenë pjesërisht efektiv në përmbushjen e misionit institucional si rregullues dhe mbikëqyrës i tregut të sigurimeve. Problematikat historike të AMF-së e të këtij tregu, administrimi nga strukturat drejtuese, si dhe vendim-marrja e Bordit, kanë cenuar mirëfunksionimin e vetë tregut, transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorit. Pavarësisht vullnetit dhe punës së mirë të drejtuesit aktual të AMF-së, pëpjekjet për të arritur objektivat emergjente dhe strategjike të paracaktuara duhet të intensifikohen.**

Në ushtrimin e kompetencave të veta sa i përket mbikëqyrjes së kompanive të sigurimit, AMF, në raste të caktuara, nuk ka vepruar gjithmonë në përputhje të plotë me ligjin duke mos marrë masat sanksionuese përkatëse, në shumën 27.400.000 lekë (gjoba të pavendosura). Autoriteti i Konkurrencës ka dështuar në bashkëpunimin me AMF-në për sigurimin e një konkurrence të lirë dhe të ndershme në tregun e sigurimeve dhe ky treg shfaq tiparet e një oligopoli.

Byroja Shqiptare e Sigurimit nuk ka përmbushur funksionin e vet dëmshpërblyes dhe mbikëqyrja e AMF-së ndaj saj nuk ka arritur pritshmëritë. Fondi i Kompensimit, edhe pse ka treguar shenja rimëkëmbjeje nga ngërçi vetëm vitin e fundit, mbart ende 277.056.933 lekë pagesa dëmsh ose rreth 25% nga shlyerja e plotë e tij.

*Nisur nga konkluzionet e mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve:*

#### **V E N D O S A:**

I. Të miratoj Raportin e Auditimit me temë **“Performanca e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”** të ushtruar në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

II. Të miratoj rekomandimet e paracaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

I. Për pyetjen: **“A ka bërë AMF transparencë dhe informim të duhur të publikut?”**

Transparenca, llogaridhënia, mbrojtja e konsumatorëve dhe besueshmëria janë parimet kryesore që përcaktojnë mirëqeverisjen e institucioneve. Mbrojtja e konsumatorëve është objektivi kryesor për Autoritetet Mbikëqyrëse të tregjeve të sigurimeve, sikurse përcaktohet edhe në Direktivën 2009/138/EC të Solvency II. Një nga mënyrat e mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet informimit është edukimi financiar. Edukimi financiar i referohet ngritjes së vetëdijes dhe aftësive të konsumatorëve dhe investitorëve rreth produkteve, koncepteve dhe rreziqeve financiare. Edhe pse dy vitet e fundit AMF ka ndërmarrë disa veprime për rritjen e edukimit financiar, duke punuar mirë në këtë aspekt, niveli është akoma shumë i ulët.



Deri në vitin 2017, AMF nuk ka patur asnjë strategji për rritjen e edukimit financiar dhe të besueshmërisë në tregje. Në faqen *ëeb* të AMF-së, megjithëse ka një seksion mbi edukimin financiar, në të janë vetëm disa materiale me koncepte bazë dhe të vjetërsuara. Nëse shohim vende të zhvilluara, duke marrë si shembull institucionin homolog të mbikëqyrësit italian të tregut të sigurimeve, IVASS, në faqen *ëeb* të tij<sup>2</sup> (fig.1) ka një kategori të veçantë vetëm për konsumatorët ku jepet informacion se si ata të mbrohen, si të zgjedhin kompaninë e sigurimit, ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e konsumatorëve, sanksionet që janë marrë ndaj secilës kompani dhe mënyrën se si mund të ankohen ndaj padrejtësive.



Fig. 1: Model i seksionit për konsumatorët në IVASS-in italian/Burimi: Grupi i auditimit

Për të vlerësuar nivelin e informimit, besueshmërinë dhe kënaqësinë e publikut mbi tregun e sigurimeve në Shqipëri, grupi i auditimit mblodhi të dhëna nëpërmjet një pyetësori (në përputhje me Manualin e Auditimit të Performancës dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Performancës ISSAI) në një kampion prej 400 të anketuarish. Pyetësori u shpërnda online në rrjete sociale (Facebook dhe LinkedIn) për të siguruar një kampion sa më përfaqësues. Nga analiza e të dhënave të mbledhura nëpërmjet pyetësorit, në lidhje me nivelin e informimit të publikut mbi tregun e sigurimeve, rezultoi se 30% e të anketuarve nuk e njohin fare AMF-në si institucion përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtij tregu, 28% e njohin pak, 32% e njohin disi dhe vetëm 10% e njohin mirë.

Në parimet themelore të sigurimeve të IAIS<sup>3</sup> cilësohet: *“Mbikëqyrësi publikon: informacion mbi rolin dhe përgjegjësitë e veta; një raport, të paktën vjetor, mbi mënyrën e realizimit të mbikëqyrjes duke përshkruar performancën e vet në ndjekjen e objektivave; informacione dhe analiza mbi situatën financiare të sektorit të sigurimeve; informacion mbi problemet ose dështimet e kompanive duke përfshirë edhe veprimtarinë mbikëqyrëse dhe masat e marra, që janë subjekte të konsideratave konfidenciale deri*

<sup>2</sup> <https://www.ivass.it/consumatori/index.html>

<sup>3</sup> International Association of Insurance Supervisors (IAIS). “The Insurance Core Principles”, November 2015, pg 19.



në pikën që nuk ekspozon ndaj rrezikut objektiva të tjera të mbikëqyrjes; pasqyrat e veta financiare të audituara, të paktën vjetore.

Gjithashtu, edhe Direktiva 2016/97 EU<sup>4</sup> përcakton: "**Autoritetet Mbikëqyrëse duhet të publikojnë të gjitha sanksionet administrative ose masa të tjera që janë vendosur për thyerje të provigjioneve të kërkuara, duke implementuar këtë direktivë dhe kundër të cilave nuk ka ndonjë apelim në fuqi deri në atë kohë, duke përfshirë edhe informacione mbi tipologjinë dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e personit përgjegjës. Sidoqoftë, aty ku publikimi i identitetit të personit juridik apo identiteti dhe të dhënat personale të personave të veçantë shihet si i rrezikuar dhe pa nevojën e domosdoshme për t'u publikuar, do të vlerësohet rast pas rasti. I njëjti parim konfidencialiteti do të përdoret edhe në rastet kur ekspozohet ndaj rrezikut stabiliteti financiar i tregut apo një hetim në vijimësi, Autoriteti duhet të publikojë pjesërisht materialin ose të publikojë masat duke ruajtur anonimitetin e personave**".

Duke u nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, grupi i auditimit gjykon se AMF, për të rritur transparencën, informimin e publikut dhe mbrojtjen e tyre, si dhe për të promovuar punën e tij, duhet të publikojë masat mbikëqyrëse dhe sanksionuese të vendosura ndaj kompanive të sigurimit. Përfshirja e vetëm do të ishte rasti i mospublikimit të emrave të personave përgjegjës për shkeljet (por vetëm të inicialeve), si dhe kur publikimi i sanksionit do të rrezikonte seriozisht stabilitetin e tregut (për t'u vlerësuar rast pas rasti) ose një hetim në proces.

#### Gjetje:

- Deri më datë 31.08.2017, AMF nuk ka pasur asnjë strategji për rritjen e edukimit financiar dhe mbrojtjen e konsumatorëve, në përputhje me objektivat e saj strategjike dhe zhvillimore dhe Ligjin për AMF-në. E-ja e cenuar e kësaj gjetjeje dhe të tjerave në vijim është *efektiviteti*, pasi institucioni nuk ka mundur të arrijë plotësisht objektivat e veprimtarisë së vet.
- Faqa zyrtare *ëeb* e AMF-së nuk ka ofruar informacion të mjaftueshëm dhe lehtësisht të kuptueshëm mbi edukimin financiar dhe mbrojtjen e konsumatorëve, sikurse dëshmojnë praktikatat e mira të institucioneve ndërkombëtare homologe, pavarësisht se vitin e fundit ka patur përmirësime të vazhdueshme.
- AMF nuk ka publikuar në faqen *ëeb* masat administrative dhe sanksionuese të vëna ndaj kompanive të sigurimit, duke mos bërë transparencë dhe informim të plotë të publikut, sikurse parashikojnë Direktiva 2016/97 EU dhe Parimet Themelore të Sigurimit.
- AMF nuk ka publikuar strategjinë e miratuar me Vendim Bordi "Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje 2017-2020", sipas parashikimit të nenit 11 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe si prioritet i vetë veprimtarisë së Autoritetit.
- AMF nuk ka ushtruar inspektime tematike në vend për të verifikuar nëse kompanitë e sigurimit zbatojnë afatet dhe procedurat e trajtimit të ankesave nga ana e konsumatorëve.

<sup>4</sup> Directive (EU) 2016/97 of the European Parliament and of the Council of 20 January 2016 on insurance distribution (recast), Article 32, pg 26. Për më tepër, shih:

<https://publications.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/71ac60f7-c97f-11e5-a4b5-01aa75ed71a1>



- Siguruesit dhe ndërmjetësit nuk i përmbushin detyrimet ligjore mbi informimin e klientëve përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit dhe në kushtet e nënshkrimit të saj, sipas neneve 63 dhe 64 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Konkretisht, i siguruari nuk merr informacion (për një ose disa pika) me shkrim mbi:
  1. procedurat e brendshme të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, si dhe strukturën përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në shkelje të pikës “c”.
  2. rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara, si dhe mundësitë për ndryshimin e kontratës, në përputhje me kushtet e përgjithshme, në shkelje të pikës “ç”.
  3. afatet dhe mënyrat e përfundimit të kontratës, në shkelje të pikës “d”.
  4. metodën e llogaritjes të primit, afatet dhe mënyrat e pagesës së tij, pasojat e mospagesës së primit, si dhe pjesën e primit që i korrespondon mbulimit bazë dhe shtesë, në shkelje të pikës “dh”.
  5. kërkesat dhe afatet për pagesën e dëmshpërblimit apo shumës së sigurimit, në shkelje të pikës “e”.
  6. procedurat jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, në lidhje me kontratën e sigurimit, në përputhje me rregullat e brendshme të siguruesit pa ndikuar në të drejtën e ankimimit në gjykatë, në shkelje të pikës “gj”.
  7. kushtet e përfundimit të njëanshëm të kontratës, në shkelje të pikës “h”.
  8. të dhëna të përgjithshme për taksat/tatimet dhe komisionet në lidhje me kontratën e sigurimit, në shkelje të pikës “i”.
- AMF, deri në fund të vitit 2017, nuk ka kryer inspektime te siguruesit dhe ndërmjetësit në lidhje me përmbajtjen e detyrimeve ligjore për informimin e klientëve për kushtet e kontratës, në kundërshtim me seksionin III të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
- Kompanitë e sigurimit nuk u përmbahen detyrimeve ligjore mbi publikimin e të dhënave të kërkuara në faqen e tyre *ëeb*, sikurse parashikon neni 66 i Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Nga vrojtimi i drejtpërdrejtë i faqeve zyrtare të kompanive nga grupi i auditimit, ka rezultuar se kompanitë nuk kanë publikuar një pjesë apo të gjithë informacionin si më poshtë:
  - I. informacione për kushtet e veçanta, rreziqet dhe mbulimet që nuk ofrohen rregullisht për një produkt sigurimi, por që mund të përfshihen si shtesë në dispozitat e kushteve të veçanta, në shkelje të gjermës “c” të pikës 3;
  - II. informacione për të drejtat dhe detyrimet e të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara, si dhe për procedurën që duhet ndjekur në rast të ndodhjes së rrezikut, në shkelje të gjermës “ç” të pikës 3;
  - III. informacionin për taksat/tatimet e zbatueshme, në shkelje të gjermës “d” të pikës 3;
  - IV. procedurën për trajtimin e kërkesës për dëmshpërblim, në shkelje të gjermës “e” të pikës 3;
  - V. formularët elektronikë që i lejojnë të siguruarit dhe palëve të tjera të interesuara të depozitojnë kërkesa për informacion dhe dëmshpërblim nëpërmjet internetit, në shkelje të gjermës “ë” të pikës 3;
  - VI. statistika dhe informacione të tjera të rëndësishme në shkelje të gjermës “f” të pikës 3;
  - VII. informacion për kontratën e sigurimit, në shkelje të gjermës “a” të pikës 4;





- VIII. informacion për kontratat e sigurimit të jetës për primet e llogaritura dhe të akumuluar, mbulimet e ofruara dhe shumat e tyre, zbritjet e mundshme, duke përfshirë këtu edhe komisionet, shpenzimet administrative dhe shpenzime të tjera, shumat e akumuluar dhe bonuset, nëse ka, shumën e dorëzimit të kontratës së sigurimit, bonuset dhe rabatet, statusin e kontratës objekt bonusi dhe rabati, në shkelje të gërmës "b" të pikës 4.
- Pjesa më e madhe e kompanive të sigurimeve nuk e kanë publikuar tabelën me primet e sigurimit sipas pikës 1 dhe 2 të nenit 10 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të provigjioneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit". Vetëm dy prej tyre i kanë publikuar, nga ku njëra prej tyre ka pasaktësi në llogaritjen e zërave të primit.

***Për sa më sipër, rekomandojmë:***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të rrisë fokusin në edukimin financiar të publikut:
  1. duke vënë në zbatim konkret përcaktimet e parashikuara në Strategjinë "Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje 2017-2020" dhe në Strategjinë "Për zhvillimin e AMF-së 2018-2022";
  2. duke shqyrtuar mundësinë e hartimit të një strategjie kombëtare mbi edukimin financiar, në bashkëpunim me institucione të tjera si Banka e Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, etj.;
  3. duke u mbështetur në praktikën e mira të institucioneve homologe të vendeve të zhvilluara.

***Në vijimësi***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të vijojë marrjen e masave të nevojshme për të përshtatur faqen *ëeb* sipas faqes së mbikëqyrësit homolog italian apo tjetër të ngjashëm të tregut të sigurimeve, ose sipas institucioneve të tjera, si *ëeb*site miqësore me përdoruesin dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme, me qëllim informimin dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

***Në vijimësi***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të publikojë në faqen *ëeb*:
  1. masat administrative dhe sanksionet e marra ndaj shoqërive të sigurimit, duke ruajtur konfidencialitetin e personave përgjegjës për shkeljet dhe në rastet kur nuk cenon seriozisht stabilitetin e tregut;
  2. strategjinë "Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje 2017-2020", për të rritur transparencën, informimin dhe mbrojtjen e publikut, në përputhje me direktivat e BE-së dhe Parimet Themelore të Sigurimit.

***Pas marrjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në vijimësi***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të kryejë inspektime tematike pranë shoqërive të sigurimit dhe ndërmjetëve mbi respektimin e detyrimit për informim parakontraktual, duke marrë të gjitha masat e nevojshme për të detyruar kompanitë e sigurimit që të përfshijnë në kontratë të gjitha informacionet e specifikuar në ligj,



si dhe të verifikojë saktësinë e raportimit mbi trajtimin e ankesave të konsumatorëve.

*Në vijimësi*

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë të gjitha masat e nevojshme që kompanitë e sigurimit të publikojnë në faqen *ëeb* të gjitha informacionet që specifikohen në Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, duke i monitoruar vazhdimisht.

*Në vijimësi*

## II. Për pyetjen: “A ka marrë masa AMF kundrejt subjekteve që kanë cenuar interesat e konsumatorit?”

Për të siguruar mbrojtje të interesave të konsumatorit, AMF *mbikëqyr* kompanitë e sigurimit nëse po e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore dhe *rregullon* nëpërmjet masave që merr ndaj tyre në rast të moszbatimit të ligjit. Në lidhje me detyrimin për informim para nënshkrimit të kontratës, në nenin 63 të Ligjit nr. 52/2014, përcaktohet se siguruesi dhe ndërmjetësit detyrohen t’i japin me shkrim çdo konsumatori, përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me llojin përkatës të sigurimit, ku në pikat e këtij neni renditen të gjitha informacionet e nevojshme. Nga inspektimet e realizuara nga AMF te ndërmjetësit, është konstatuar se informacioni që i jepet konsumatorit nuk është i plotë sipas parashikimeve të nenit 63.

Tregues mjaft të rëndësishëm të shëndetit financiar të kompanive të sigurimit janë edhe testet e paralajmërimit të hershëm. Testet e Paralajmërimit të Hershëm (*Early Earning Tests*) konsistojnë në një sërë treguesish financiarë, të cilët konsiderohen si tregues kyç të sinjalizimit për fillimin e dobësisë financiare tek shoqëritë e sigurimit.

Qëllimi i këtyre testeve është që, duke vepruar si tregues të paralajmërimit të hershëm, të ndihmojnë mbikëqyrësin në vendosjen e përparësive për shpërndarjen e burimeve në monitorimin e shoqërive të sigurimeve. Pavarësisht disa kufizimeve dhe paralajmërimeve, raportet janë pranuar në mënyrë ndërkombëtare nga mbikëqyrësit në të gjithë botën, pasi është konstatuar se ato japin një kontribut mjaft të dobishëm për matjen e rrezikut të shoqërisë së sigurimit.

**Tab. 1:** Raporti dëme/prime dhe shpenzime/prime

	Raporti dëme/prime neto (%)				Raporti shpenzime/prime neto (%)			
	2015	2016	2017	Diapazoni i kërkuar (%)	2015	2016	2017	Diapazoni i kërkuar (%)
<b>Albsig</b>	27.00%	25.18%	28.86%	50% - 80%	53.92%	68.31%	65.41%	25% - 50%
<b>Ansig</b>	21.39%	31.83%	25.47%		70.44%	90.06%	76.31%	
<b>Atlantik</b>	23.19%	27.92%	22.64%		63.86%	67.27%	68.26%	
<b>Eurosig</b>	34.68%	33.73%	28.84%		72.48%	69.60%	66.17%	
<b>Insig</b>	60.35%	11.64%	25.61%		47.49%	77.18%	74.42%	
<b>Sigal</b>	40.43%	32.84%	32.84%		58.61%	61.37%	61.37%	
<b>Intersig</b>	41.67%	33.73%	38.69%		50.15%	63.75%	53.43%	
<b>Sigma</b>	57.19%	38.51%	44.57%		48.58%	67.22%	55.84%	

Burimi: AMF, përpunimi nga grupi i auditimit



Në tabelën e mësipërme janë paraqitur dy nga treguesit e paralajmërimit të hershëm, që janë raporti dëme/prime neto dhe shpenzime/prime neto, pasi janë treguesit më të rëndësishëm që ndikojnë në interesat e konsumatorëve dhe në masën e dëmshpërblimeve që ata marrin. Raporti dëme/prime tregon se sa nga paratë që marrin kompanitë nga primet e shitura, i japin për të dëmshpërblyer klientët. Ky raport është në nivele shumë të ulëta, ku luhetet në një mesatare tregu rreth **32%**, ndërsa diapazoni i kërkuar është **nga 50% deri në 80%**. Në vendet e rajonit ky tregues është më i lartë, me një mesatare tregu 45%, që do të thotë se vendet e rajonit paguajnë më shumë dëme sesa kompanitë në Shqipëri.

Ky rezultat i ulët i raportit dëme/prime, vjen si pasojë e shpenzimeve operative shumë të larta që kanë kompanitë e sigurimit. Nëse vërejmë tabelën, raporti shpenzime/prime që nënkupton se sa nga paratë që marrin kompanitë nga primet e shitura, përdoren për shpenzimet e tyre të funksionimit të biznesit, **është në nivele shumë të larta me një mesatare tregu rreth 65%**, kur diapazoni i kërkuar është **25-50%**. Paraqitja e vlerave të këtyre dy treguesve nënkupton se kompanitë e sigurimit, paratë e fituara nga shitja e primeve, i shpenzojnë në një masë shumë të madhe për shpenzime të zhvillimit të biznesit dhe nuk i përdorin për qëllimin e tyre primar për të dëmshpërblyer në një masë më të madhe konsumatorët.

#### Gjetje

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk ka marrë masat e specifikuar në gjurmën d) të pikës 1 të nenit 246 të Ligjit 52/2014 ndaj kompanive të sigurimit të cilat nuk kanë përmbushur detyrimet për informimin e publikut nëpërmjet faqes zyrtare, sikurse kërkohet në nenin 66 të këtij ligji. Edhe ato për eliminim shkeljesh, të marra nga AMF, nuk kanë rezultuar efektive pasi kompanitë nuk i kanë zbatuar ende të gjitha kërkesat ligjore sa i përket faqes së tyre elektronike.
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk ka marrë masat e përcaktuara në gjurmën a) të pikës 1 të nenit 248 të Ligjit 52/2014 ndaj kompanive të sigurimit të cilat nuk përmbushin detyrimet për informimin parakontraktual të klientit, sikurse kërkohet në nenin 63 të këtij ligji.
- Treguesit e aftësisë paguese dhe aktiveve në mbulim të provigjioneve teknike të disa shoqërive sigurimi janë nën nivelin e kërkuar, përkatësisht, nga neni 80 i Ligjit nr. 52/2014 (vlera më e lartë midis fondit të garancisë dhe 150% të kufirit minimal të aftësisë paguese) dhe neni 96 i po këtij ligji (jo më e vogël se shuma bruto e provigjioneve teknike).
- Bordi i AMF-së nuk ka marrë masa të përshkallëzuara sipas parashikimeve të nenit 152 të Ligjit 52/2014 për ato kompani sigurimi që kanë shkelur vazhdimisht disa nga pikat e nenit 150 të këtij ligji mbi treguesit e aftësisë paguese dhe aktiveve në mbulim të provigjioneve teknike.
- Duke marrë parasysh situatën problematike të pagesës së dëmeve nga shoqëritë e sigurimit, AMF nuk ka ushtruar inspektime tematike gjatë periudhës 2015-2017. Pavarësisht se kompanitë raportojnë tek AMF me anë të sistemit të informacionit për administrimin e dëmeve, nga inspektimet e kryera në vitin korrent, ka rezultuar se këto sisteme nuk janë plotësisht funksionale duke patur pasaktësi dhe parregullsi në raportime. Kështu, disa nga shoqëritë kanë shkelur përcaktimet e nenit 12 të Ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e



transportit” dhe Rregullores “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, pasi:

- kanë refuzuar pagesën e dëmeve pa të drejtë;
  - kanë mbajtur pezull dëmet pa arsye;
  - nuk kanë trajtuar në kohën dhe mënyrën e duhur ankesat e konsumatorëve;
  - kanë kryer vlerësime dëmsh nga punonjës të papajisur me licencën specifike si “Vlerësues dëmsh”;
  - nuk kanë pasur komunikim të rregullt me kërkuesit e dëmshpërblimeve në lidhje me plotësimin e dokumentacionit përkatës dhe njoftimin për masën e dëmshpërblimit.
- Raporti dëme/prime në tregun e sigurimeve paraqitet në nivele të ulëta (rreth 32%), nëse e krahasojmë me vendet e tjera të rajonit që kanë një mesatare rreth 45%, ndërsa në vendet e zhvilluara luhetet në një diapazon 50%-80%. Në këtë prizëm, kompanitë kanë dhe një nivel të lartë shpenzime/prime. Kjo gjetje karakterizohet nga një mungesë, përkatësisht, efiçiense (paguajnë pak dëme (output) në raport me primet që shesin (input) dhe ekonomikiteti (shpenzime të tepërta).

***Për sa më sipër, rekomandojmë:***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë të gjitha masat përkatëse ndaj kompanive të sigurimit në raste shkeljesh të përsëritura të ligjit, sa i përket detyrimit të tyre për informim të publikut dhe konsumatorit nëpërmjet faqes elektronike dhe informacionit parakontraktual të dhënë.

***Në vijimësi***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë të gjitha masat e përshkallëzuara ndaj kompanive të sigurimit të cilat nuk arrijnë nivelet e kërkuara të treguesve financiarë që cenojnë drejtpërdrejt interesat e konsumatorëve.

***Në vijimësi***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të monitorojë vazhdimisht përmirësimin e treguesit të raportit shpenzime/prime nga shoqëritë e sigurimeve, deri sa të arrijnë nivelin 40%, sikurse përcaktohet edhe në nenin 7, pika 6, të Projekt-ligjit të ri “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

***Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri***

---

**III. Për pyetjen: “A ka mangësi në kuadrin ligjor dhe rregullator të fushëveprimit të AMF-së?”**

Pas krijimit të AMF-së në vitin 2006 si bashkim i tre autoriteteve rregullatore mbikëqyrëse, procesi i rregullimit dhe mbikëqyrjes ka përjetuar një zhvillim cilësor në drejtim të strukturimit dhe standardizimit. Viti 2014 ka shënuar një moment të rëndësishëm në forcimin e pavarësisë së AMF-së, me ndryshimet ligjore, duke u barazuar me institucionet e tjera financiare në vend. Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve dhe mbështetjes së konsiderueshme të BB-së dhe FMN-së, procesi



rregullator dhe mbikëqyrës nuk ka ndjekur me të njëjtin ritëm zhvillimin e tregjeve financiare dhe për pasojë, edhe sot AMF vijon të përballet me mjaft sfida.<sup>5</sup>

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator është një objektivi i rëndësishëm i AMF-së për të rritur shkallën e përafrimit me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të tregut financiar jobankar. Vëmendje të veçantë në këtë aspekt kërkon Projekt-ligji i ri “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili është hartuar nga AMF, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe BSSH-ja me qëllim përmirësimin e bazës ligjore të sigurimit të detyrueshëm dhe përfshirjen si të detyrueshme të produkteve të reja të sigurimit në sektorin e transportit.<sup>6</sup>

Një çështje me mjaft rëndësi e këtij auditimi ishte ajo mbi tepricat e buxhetit vjetor të AMF-së. Në paragrafin 4 të nenit 27 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, përcakohet se “*çdo tepricë që mbetet nga të ardhurat vjetore të Autoritetit njihet dhe regjistrohet si paradhënie e subjekteve të mbikëqyrura për periudhën pasardhëse, duke e shpërndarë në mënyrë përpjesëtimore me kontributin e tyre*”. Kështu, bashkë me të ardhurat që grumbullon AMF nga pagesat e shoqërive janë dhe gjobat, të cilat mund t’u vendosen atyre gjatë një viti ushtrimor dhe kur mbyllen pasqyrat financiare të AMF-së, në rezultat përfshihen dhe të ardhurat nga gjobat. Në këto kushte, kjo tepricë që u njihet shoqërive si paradhënie, mbart dhe një pjesë të gjobës që ato kanë paguar për një shkelje të konstatuar më parë.

Një evidencë tjetër që mori në shqyrtim grupi i auditimit është modeli i pasqyrës financiare të një prej kompanive të sigurimit. Nëse shyrtojmë zërin 3.3 “Tatime dhe taksa të tjera të ngjashme” të kategorisë I “**Shpenzime administrative**”, vërejmë se aty janë llogaritur **shumat që derdh kompania si kontribut vjetor në AMF**. Gjithashtu, në Aneksin II të Raportit, është paraqitur formula e llogaritjes së primit të sigurimit. Nga kjo formulë rezulton se kompanitë, për të llogaritur primin final, marrin në konsideratë, ndër të tjera, edhe **variablin -β shpenzime administrative**. Pra, **në çmimin final të çdo police sigurimi, qytetari i siguruar paguan edhe pjesën përkatëse të kuotës që kompania i paguan AMF-së** (infografiku 12 i Raportit). Nga kjo rrjedh se një burim i konsiderueshëm i të ardhurave të AMF-së vjen prej qytetarëve që blejnë polica të ndryshme sigurimi, përmes kompanive.

I ndërgjegjshëm për mënyrën e financimit të AMF-së (jo nga buxheti i shtetit), faktit se i siguruari kontribuon indirekt në të ardhurat e saj, si dhe tepricës që mbetet në fund të çdo viti ushtrimor të Autoritetit, grupi i auditimit gjykon se është i nevojshëm ndryshimi i destinacionit të këtyre tepricave, nga kompanitë tek AMF-ja.

Duke marrë parasysh sfidat dhe problemet me të cilat përballet vendi ynë nga ndotja e mjedisit dhe infrastruktura rrugore, AMF, pas ndryshimeve të nevojshme ligjore, duhet të shohë mundësinë e përdorimit të këtyre tepricave për investime të vetë institucionit dhe kontribute në iniciativa mjedisore dhe infrastrukturë rrugore, sipas rastit.

Kjo konsideratë vjen si një “*green solution*” për faktin se ndotësit më të mëdhenj të mjedisit dhe dëmtuesit më të mëdhenj të infrastrukturës rrugore janë pikërisht mjetet motorike. Kësisoj, pjesë e tepricave të buxhetit të AMF-së mund të shkojnë për llogari

<sup>5</sup> Strategjia 2018-2022 për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

<sup>6</sup> Relacion për Projekt-ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

<http://amf.gov.al/pdf/fokus/Projekt%20ligj%20P%C3%ABr%20sigurimin%20e%20detyruesh%C3%ABm%20n%C3%AB%20sektorin%20e%20transportit.pdf>




të këtij fondi qëllimor. Kjo është në përputhje edhe me modelin e përgjegjësisë sociale të korporatave<sup>7</sup>, si dhe është pranuar gjerësisht edhe nga vetë AMF-ja.

Institucionet supreme të auditimit dhe veçanërisht auditimet e performancës po shkojnë gjithnjë e më shumë drejt "zgjidhjeve të gjelbërta", si duke audituar E-në e gjashtë (Environment-Mjedisi), ashtu edhe duke dhënë rekomandime "miqësore me mjedisin".

Një çështje tjetër që grupi i auditimit mori në shqyrtim në lidhje me hartimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor është ajo mbi përcaktimin e nenit 45 të Ligjit nr. 10076/2009 mbi burimet e Fondit të Kompensimit. Pika 3 liston si burime të FK, ndër të tjera, edhe gjobat e vëna pronarit të mjetit të transportit, kur nuk është lidhur kontrata e sigurimit të detyrueshëm. Nga ana e tij, ky nen kontraston me nenin 203, pika 3 e Kodit Rrugor të RSH i cili parashikon se "të ardhurat nga gjobat për shkeljet e parashikuara nga ky kod i kalojnë në masën 60% organit që ka verifikuar shkeljen dhe në masën 40% buxhetit të shtetit". Grupi i auditimit konstatoi se arkëtimi i gjobave për llogari të FK, ndaj mjeteve të transportit, nuk ka ndodhur për arsye të kësaj mospërputhjeje ligjore.

#### Gjetje:

- Për vitin 2015, tepricat buxhetore të AMF-së që u janë njohur si parapagim subjekteve private, kanë qenë 25.149.080 lekë, për vitin 2016 kanë qenë 83.149.080 lekë, ndërsa për vitin 2017 suficiti ishte në shumën 59.360.000 lekë.
- Gjobat e vëna nga organet kompetente ndaj personave me mjet motorik të pasiguruar nuk janë arkëtuar nga Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe nuk kanë



<sup>7</sup> CSR: Corporate Social Responsibility = Përgjegjësia Sociale e Korporatave

shërbyer si burim i të ardhurave për Fondin e Kompensimit për shkak se neni 45 i Ligjit nr. 10076/2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" është në kontrast me nenin 203, pika 3, e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se "të ardhurat nga gjocat për shkeljet e parashikuara nga ky kod i kalojnë në masën 60% organit që ka verifikuar shkeljen dhe në masën 40% buxhetit të shtetit".

***Për sa më sipër, rekomandojmë:***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me institucionet kompetente si Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Kuvendi, të marrë masat e nevojshme për të mundësuar miratimin e Projekt-ligjit të ri "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

***Brenda muajit Mars 2019***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat përkatëse për të hartuar aktet nënligjore të nevojshme për të detajuar dhe rregulluar procedurat dhe afatet e ndryshimeve legislative të kryera në Ligjin nr. 10076/2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

***Pas miratimit të ligjit përkatës***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pas ndryshimeve të nevojshme ligjore, të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një fondi qëllimor me tepricat e buxhetit që mbeten në fund të çdo viti ushtrimor, në përputhje me parimin e ekonomicitetit, për të kontribuar në iniciativa mjedisore dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.

***Brenda muajit Qershor 2019***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të hartojë një plan veprimi në fillim të çdo viti për menaxhimin e fondit qëllimor, krijuar nga tepricat e vitit paraardhës, duke mbajtur një balancë midis investimeve institucionale të nevojshme dhe kontributeve të sipërpërmendura.

***Në vijimësi dhe brenda muajit Janar të çdo viti<sup>8</sup>***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë parasysh të gjitha studimet shkencore dhe mendimet e ekspertëve të paanshëm të fushës, sa i përket llogaritjes së çmimit të një police sigurimi, duke kryer hetimet përkatëse në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, për të siguruar një transparencë dhe mbrojtje sa më të mirë konsumatorëve.

***Në vijimësi***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat përkatëse për t'i propozuar institucioneve përgjegjëse ndryshimet e nevojshme ligjore në mënyrë që neni 45 i Ligjit nr. 10076/2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" të mos ketë mospërputhje me nenin 203, pika 3, e Kodit Rrugor të Republikës së

---

<sup>8</sup> Për vitin 2019, që do të jetë dhe viti i parë i implementimit të kësaj reforme, zbatimi i këtij rekomandimi të kryhet brenda 6-mujorit të parë të vitit.



Shqipërisë. Një ndryshim i tillë mund të përfshijë dispozitën e Kodit Rrugor, duke shtuar togfjalëshin si në vijim:

“Të ardhurat nga gjobat për shkeljet e parashikuara nga ky kod i kalojnë në masën 60 përqind organit që ka verifikuar shkeljen. Këto të ardhura, **përveç atyre që vijnë nga gjobat ndaj mjeteve motorike të pasiguruara**, do të përdoren për përmirësimin e shërbimit në zbatim të këtij Kodi, kurse 40 përqind i kalojnë shtetit. Kalimi i të ardhurave në buxhet bëhet sa herë që derdhen para në bankë, duke respektuar raportin e lartpërmendur.”

*Brenda muajit Mars 2019*

#### IV. Për pyetjen: “A është zbatuar legjislacioni në fuqi sipas detyrave dhe kompetencave të AMF-së”?

Grupi i auditimit mori në shqyrtim vendimet e Bordit mbi inspektimet e kryera në kompanitë e sigurimit dhe masat e marra ndaj tyre për periudhën nën auditim 2015-2017. Kompanitë kanë patur në mënyrë të përsëritur shkelje të dispozitave ligjore, kryesisht me treguesit e aftësisë paguese dhe likuiditetit, raportimin financiar, administrimin e rrezikut, marrjen në sigurim të përgjegjësive që tejkalojnë mbulimin maksimal të tyre dhe risigurimin në kundërshtim me nenin 116 të Ligjit nr. 52/2014, etj. Thuajse pas çdo inspektimi të kompanive dhe evidentimi të shkeljeve nga ana e Autoritetit, është vendosur nxjerrja e urdhrat për eliminimin e këtyre papërputhshmërive apo edhe marrja e planit të masave për rimëkëmbjen.

Megjithatë, Autoriteti jo gjithmonë ka vendosur sanksione me gjobë ndaj kompanive të sigurimit, sipas Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, për ato shkelje për të cilat parashikohet ky lloj sanksioni. Grupi i auditimit është i ndërgjegjshëm se sanksionet me gjobë nuk e zgjidhin kurdoherë situatën e një shkelësi dhe parimi i “humanizimit të ndëshkimit”, sikurse parashikon dhe jurisprudenca penale, është i nevojshëm në raste të caktuara për t’i ardhur në ndihmë një subjekti. Sidoqoftë, rasti konkret na gjen përballë shkeljeve sistematike dhe të përsëritura vit pas viti nga kompanitë e sigurimeve.

Në tabelën vijuese janë evidentuar të gjitha Vendimet e Autoritetit në të cilat janë marrë masa mbikëqyrëse për kompanitë, sëbashku me shkeljet përkatëse dhe sanksionet me gjobë, të munguara, sipas legjislacionit në fuqi. Vlerat janë marrë për çdo shkelje të kryer si nga vetë kompania, ashtu edhe nga personi përgjegjës dhe të reflektuar në vendimet përkatëse të Bordit pas analizave financiare, inspektimeve dhe/ose raportimeve në Autoritet.

Tab. 2

**Vendime Bordi 2015**

Vendimi i bordit	Shkelje	Masa sanksionuese me gjobë	Vlera minimale	Vlera maksimale
Vendim Nr. 72, Datë 28.07.2015	Neni 125 i Ligjit nr. 52/2014	Neni 246/3/c	1.000.000	1.200.000





	Neni 116 i Ligjit nr. 52/2014	Neni 246/1/h	2.300.000	3.400.000
Vendim Nr. 71, Datë 28.07.2015	Neni 111/ 5 i Ligjit nr. 52/2014	Neni 246/l	2.300.000	3.400.000
	Neni 116 i Ligjit nr. 52/2014	Neni 246/1/h	2.300.000	3.400.000
Vendim Nr. 73, Datë 28.07.2015	Neni 125 i Ligjit nr. 52/2014	Neni 246/3/c	1.000.000	1.200.000
Vendim Nr. 74, Datë 28.07.2015	Neni 125 i Ligjit nr. 52/2014	Neni 246/3/c	1.000.000	1.200.000
	Neni 116 Neni 110	Neni 246/1/h Neni 246/1/k	2.300.000 2.000.000	3.400.000 3.000.000
Vendim Nr. 86, Datë 30.09.2015	Neni 109-112 i Ligjit nr. 52/2014	Neni 246/1/1	4.600.000	6.800.000
<b>Totali 2015</b>			<b>18.800.000</b>	<b>27.000.000</b>

#### Vendime Bordi 2016

Vendimi i bordit	Shkelje	Masa sanksionuese me gjobë	min	max
Vendim Nr. 116, Datë 19.07.2016	Neni 116 i Ligjit nr. 52/2014	Neni 246/1/h	2.300.000	3.400.000
Vendim Nr. 117, Datë 19.07.2016	Neni 116 i Ligjit nr. 52/2014	Neni 246/1/h	4.600.000	6.800.000
<b>Totali 2016</b>			<b>6.900.000</b>	<b>10.200.000</b>

#### Vendime Bordi 2017

Vendimi i bordit	Shkelje	Masa sanksionuese me gjobë	min	max
Vendim Nr. 1, Datë 03.02.2017	Neni 256/1	Neni 256/1	300.000	1.000.000
Vendim Nr. 2, Datë 03.02.2017	Neni 256/1	Neni 256/1	300.000	1.000.000
Vendim Nr. 4, Datë 03.02.2017	Neni 144	Neni 246/3/dh	1.100.000	1.400.000
<b>Totali 2017</b>			<b>1.700.000</b>	<b>3.400.000</b>

**Totali 2015-2017**

**27.400.000**

**40.600.000**



Pas llogaritjes së shumës së masave sanksionuese me gjobë të pavendosura, rezulton një shumë midis masës **27.400.000 lekë** për minimumin e sanksionit dhe asaj **40.600.000 lekë** për vlerën maksimale të tij. Për këtë arsye, kjo shumë nuk është vjelë sipas legjislacionit në fuqi dhe përbën monetarizimin e cenimit të parimit të **efektivitetit**, përkundërt funksionit mbikëqyrës të AMF-së.

#### **Gjetje:**

- Përgjatë periudhës 2015-2017, kompanitë e sigurimeve nuk kanë zbatuar plotësisht rekomandimet dhe masat e dhëna nga AMF mbi çështje si raportimi i pasaktë financiar, shkeljet e rënda të rregullave të administrimit të riskut, treguesit e ulët të aftësisë paguese dhe likuiditetit, marrja në sigurim e përgjegjësive që tejkalojnë mbulimin maksimal të tyre, etj.
- AMF, gjatë periudhës nën auditim, nuk ka ushtruar plotësisht kompetencat e saj në vendosjen e masave sanksionuese me gjobë sipas Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të cilat, nëse do të vendoseshin dhe mblidheshin, do të përbënin një shumë totale prej **27.400.000 lekësh** minimumi i sanksionit dhe **40.600.000 lekë** maksimumi. Për vitin 2015, kjo shumë ka qenë 18.800.000 lekë, për vitin 2016, ka qenë 6.900.000 lekë dhe për vitin 2017, 1.700.000 lekë.

#### ***Për sa më sipër, rekomandojmë:***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë të gjitha masat e nevojshme për të zbatuar me përpikmëri të gjitha përcaktimet rregullative, mbikëqyrëse dhe sanksionuese të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, duke vendosur edhe masa administrative me gjobë në raste shkeljesh të dispozitave përkatëse.

***Në vijimësi***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përkrah inspektimeve të bazuara në risk, të rrisë numrin e inspektimeve tematike, *on-site* dhe *off-site*, të atyre në bashkëpunim me institucione të tjera partnere, si dhe të inspektimeve pranë ndërmjetësve me qëllim verifikimin e treguesve financiarë të raportuar, dëmshpërblimet apo skema të mundshme mashtrimi.

***Në vijimësi***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë të gjitha masat e nevojshme për të shtuar stafin e kualifikuar dhe me përvojë, me synim përmbushjen me sukses të funksionit mbikëqyrës të institucionit në tregun financiar jobankar.

***Brenda vitit 2019***

---

#### **V. Për pyetjen: “A ka bashkëpunuar AMF me Autoritetin e Konkurrencës me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve?”**

Baza ligjore që parashikon bashkëpunimin e dy autoriteteve mbikëqyrëse, AMF-së dhe AK-së, gjendet si në Ligjin 9572/2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” (neni 18/1), ashu edhe në Ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (neni 70/3). I pari përcakton se AMF bashkëpunon me autoritete të tjera financiare, *vendase* apo të




huaja, me autoritete të tjera mbikëqyrëse në sektorin financiar duke kryer inspektime të përbashkëta dhe duke shkëmbyer informacione. Në të njëjtën linjë qëndron edhe ligji i konkurrencës i cili cilëson se AK bashkëpunon me entet dhe institucionet e tjera rregullatore për zbatimin e tij në sektorët e rregulluar.

Grupi i auditimit mori në shqyrtim nga AMF korrespondencën midis dy autoriteteve për vitet 2015-2018 (Tetor). Nga kjo korrespondencë konstatohet se dy institucionet kanë shkëmbyer mendime dhe informacione në lidhje me:

- hartimin e modelit të sistemit Bonus-Malus në sigurimin MTPL e brendshme;
- projekt-ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”;
- vendime të Komisionit të Konkurrencës dhe Bordit të AMF-së në lidhje me tregun e sigurimeve;
- vendime të AK-së për nisjen dhe mbarimin e procedurës së hetimit paraprak ose të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik.

Megjithatë, institucionet rregullatore dhe mbikëqyrëse, përgjatë periudhës objekt auditimi, nuk kanë patur një bashkëpunim konkret, konstruktiv dhe eficient midis tyre, duke i parë dispozitat ligjore përkatëse më shumë si “përmbushje burokratike” dhe thjesht formale të tyre, se sa zbatim i detyrimit ligjor dhe funksionit të tyre të përbashkët në drejtim të mbrojtjes konsumatore.



**Infografik 4/Burimi: Grupi i auditimit**

#### Gjetje:

- Autoriteti i Konkurrencës dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk kanë zbatuar reciprokisht përcaktimet e nenit 18/1 të Ligjit nr. 9572/2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe të nenit 70, pika 3, të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” sa i përket bashkëpunimit konkret në sektorin e tregut të sigurimeve.
- Nga shqyrtimi i korrespondencës AMF-AK, u konstatua se institucionet ia kanë kaluar njëra-tjetrës përgjegjësinë për mbikëqyrje të tregut dhe sigurim të konkurrencës së lirë dhe të ndershme, duke shkëmbyer vetëm informacione për çështje sporadike dhe mendime për ndryshime legjislative.

- AK nuk është treguar i gatshëm të kryejë inspektime të përbashkëta me AMF-në sipas nenit 18/1, pika 1, për çështjet objekt veprimtarie të të dy institucioneve, si dhe nuk ka zbatuar rekomandimin e Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së AMF-së për vitin 2017”, datë 21.06.2018, mbi thellimin e bashkëpunimit për verifikimin e bashkëpunimit në shitjen e policave MTPL nga ndërmjetësit në sigurime.

***Për sa më sipër, rekomandojmë:***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoriteti i Bashkëpunimit të marrin të gjitha masat për të vendosur një bashkëpunim institucional të ngushtë dhe konkret mbi çështjet që lidhen me tregun e sigurimeve dhe mbarëvajtjes së një konkurrence të lirë dhe të ndershme, duke kryer edhe inspektime të përbashkëta.

***Në vijimësi***

- Autoriteti i Konkurrencës të marrë në konsideratë gjetjet, inspektimet dhe propozimet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si autoriteti mbikëqyrës i posaçëm për tregun e sigurimeve, kur këto kanë për objekt veprime/mosveprime të kompanive të sigurimit që cenojnë konkurrencën dhe konsumatorin, si dhe të nisë procedurat përkatëse për hetimin e tregut.

***Në vijimësi***

**VI. Për pyetjen: “A ka siguruar AK një konkurrencë të lirë dhe të ndershme në tregun e sigurimeve?”**

Në lidhje me këtë pyetje, grupi i auditimit nuk ka gjeneruar një përgjigje të plotë për shkak të mungesës së bashkëpunimit të Autoritetit të Konkurrencës me grupin e auditimit. Njoftimi zyrtar për shtrirjen e auditimit edhe pranë AK-së u bë me anë të Programit të Auditimit nr. prot. 782/2, datë 15.10.2018. Në vijim të Programit, grupi i auditimit përgatiti intervistën për AK me qëllim grumbullimin e të dhënave primare që do të përdorëshin më pas për t’u kryqëzuar dhe testuar me të dhënat sekondare që merren nga subjekti nën auditim. Një praktikë e tillë pune, ku grupi auditues i drejtohet titullarëve të institucioneve me pyetësorë dhe intervista është në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Performancës ISSAI (3100 dhe 3200).

Në këtë mënyrë, grupi i auditimit i nisi një email zyrtar Kryetares së Autoritetit të Konkurrencës, znj. Juliana Latifi, duke i bashkëngjitur intervistën me pyetjet përkatëse (Aneksi I, Intervista II, e këtij projekt-raporti). Kryetarja e AK refuzon t’i përgjigjet intervistës së grupit auditues, dërguar me email në përputhje me vizionin “paperless” të Departamentit të Auditimit të Performancës në KLSH dhe në miqësi me mjedisin, duke theksuar se “sipas hierarkisë së Administratës Publike ka një standard komunikimi midis institucioneve” dhe se AK duhej të përgjigjej vetëm në referencë të pyetjes 1.3.2. të Programit “A ka siguruar AK një konkurrencë të lirë dhe të ndershme në tregun e sigurimeve?”.

Dërgimi i një email-i zyrtar për mbledhjen e informacioneve nga intervistat me titullarët e institucioneve nga ana e grupit të auditimit, është në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe një praktikë e përdorur gjerësisht nga Institucionet Supreme të Auditimit. Ndërkohë, pyetjet e Piramidës së Pyetjeve janë ngritur nga grupi auditues dhe atyre do t’u japë përgjigje po ai. Titullarët ose përfaqësuesit e



institucioneve u japin përgjigje pyetjeve që bëhen në pyetësorë/intervista të drejtpërdrejta ose me anë email-i.

Grupi i auditimit thekson se të gjitha pyetjet e Intervistës me lëndë “Intervistë për marrjen e të dhënave zyrtare”, drejtuar Kryetares së Autoritetit të Konkurrencës, janë nënpyetje të lidhura me çështjen e ngritur në Program dhe asnjë prej tyre nuk del përtej objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës.

Nga sa më lart, KLSH nuk ka mundur të auditojë Autoritetin e Konkurrencës. AK ka penguar mbarëvajtjen e punës së grupit auditues duke shkelur, kështu, edhe Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në veçanti nenet 10, 13, 15 dhe 26. Ky i fundit, mbi aksesin e pakufizuar në dokumentet zyrtare nga ana e KLSH-së, përcakton në pikat 1 dhe 2:

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave, si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuar në këtë ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore.

2. Të gjitha subjektet e audituara janë të detyruara t’i sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare sipas paragrafit të mësipërm. Në rast të hasjes së pengesave, veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me të drejtat e mësipërme, Kontrolli i Lartë i Shtetit i drejtohet, sipas rastit, organit më të lartë administrativ ose organeve të pushtetit gjyqësor.

---

## VII. Për pyetjen: “A e ka përmbushur misionin e saj ligjor Byroja Shqiptare e Sigurimit?”

Byroja Shqiptare e Sigurimit është enti publik që ka si funksione kryesore menaxhimin e Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil (TPL ndërkombëtare) dhe menaxhimin e Fondit të Kompensimit. Funksioni i parë ka për qëllim garantimin e detyrimeve financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Jeshil; i dyti pagesën e dëmeve pasurore dhe jopasurore, të ndodhura në territorin e RSH, ndaj pasagjerit të pasiguar, përdorimi i një mjeti motorik të pasiguar, të pidentifikuar ose në rastin e falimentimit/mbylljes së shoqërisë së sigurimit. Ndërsa Sistemi i Kartonit Jeshil lehtëson rrjedhën e trafikut rrugor në kalimin e kufijve në Evropë dhe garanton kompensimin e viktimave vendase të aksidenteve të shkaktuara nga automobilistët e huaj. **Fondi i Kompensimit** është një fond i veçantë që krijohet për kompensimin e palëve të dëmtuara si pasojë e një aksidenti automobilistik të shkaktuar nga një mjet motorik, sikurse përcaktohet nga Ligji mbi “Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit” nr. 10076 datë 12.02.2009, Kreu V, neni 45, si dhe Rregullorja “Mbi krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”.

Statuti i Byrosë parasheh tri organe të saj që përbëhen nga të njëjtët persona juridikë që vetëzgjidhen: Anëtarësia, Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Administrativ. Asambleja e Përgjithshme është e përbërë nga përfaqësuesit e çdo kompanie që licencohet për të ofruar në treg produktet e sigurimeve. Asambleja është organi më i lartë i Byrosë dhe ka të drejtën e marrjes së vendimeve për të gjitha çështjet<sup>9</sup>. Këshilli

---

<sup>9</sup> Sipas Statutit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, i cili ka hyrë në fuqi me miratimin e AMF-së.



Administrativ përbëhet nga jo më pak se 8 anëtarë nga të cilët 7 anëtarë me të drejtë vote, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve dhe një anëtar pa të drejtë vote, i zgjedhur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Këshilli Administrativ, me shumicë të thjeshtë votash, zgjedh Kryetarin e tij. Pra, Këshilli Drejtues i Byrosë është i përbërë nga Drejtorët Ekzekutivë të kompanive të sigurimit. Asambleja zgjedh me votë Drejtorin Ekzekutiv të BSHS-së, i cili udhëheq, praktikisht, vetëm në bazë të vendimeve të Asamblesë/Këshillit. Në vijim, vendimet lidhur me shlyerjen e dëmeve objekt të Fondit të Kompensimit, merren nga Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues i BSHS-së. Sikurse evidentohet nga konstatimet e grupit të auditimit dhe inspektimet e AMF-së në Byro, një nga arsyet e zvarritjes së shlyerjes së dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit është edhe fakti se vetë kompanitë që *de facto* e drejtojnë Byronë, nuk kanë qenë të gatshme të kryejnë sipas detyrimeve përkatëse pagesat e FK. Grupi i Auditimit gjykon se BSHS-ja duhet të ristrukturohet në mënyrë që të shmanget ky konflikt interesi në vendimmarrje. Kështu, në vendimmarrjen e organeve të Byrosë paraqitet konflikt interesi midis vendimeve të këtij organi dhe funksioneve kryesore që ka BSHS për të dëmshpërblyer konsumatorin në rastet e FK. Gjithashtu, vendimi për shlyerjen e dëmeve nuk duhet të lihet më në vullnetin e kompanive, por duhet respektuar në mënyrë rigorozë pika 4 e nenit 38 e Rregullores nr. 53/2009, nxjerrë nga Bordi i AMF, ku sanksionohet: *“Të gjitha dosjet, objekt i Fondit të Kompensimit, brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e plotësimit të dokumentacionit dërgohen për miratim dhe pagesë pranë Byrosë.”* Për çdo rast që AMF verifikon se ky nen nuk është respektuar, duhet të marrë masa të përshkallëzuara deri në gjobitjen e Drejtorit Ekzekutiv ose tërheqjen e miratimit për anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë së sigurimit, sipas neneve 13-14 të Ligjit nr. 10076/2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Për të gjitha këto problematika, nga AMF janë marrë vetëm masa këshillimore, të cilat nuk kanë çuar në zgjidhje. Nga sa më sipër, grupi auditues është i mendimit se problemet e mësipërme kanë ardhur edhe nga mungesa e mbikëqyrjes së kujdesshme të AMF-së mbi BSHS-në. Kjo neglizhencë ka ndikuar në përkeqësimin e situatës së Byrosë. Në këto kushte emergjente, Autoriteti duhet të ushtrojë më rigorozisht kompetencat që i njeh ligji aktual mbi Byronë dhe forcimin e tyre pas miratimit të projekt-ligjit të ri, për sa i takon ecurisë pa asnjë cen të shlyerjes së dëmeve objekt i FK. Këto kompetenca të shtuara duhet ta rimëkëmbin Byronë, duke e kthyer nga ngjashmëria me një shoqëri private aksionerësh të të njejtit treg, në një ent publik nën varësinë e AMF-së, pas shpërbërjes në Ent Kompensimi dhe i cili vendos interesin e qytetarëve mbi çdo interes të tregut.

#### Gjetje:

- Kompanitë e sigurimit kanë patur probleme të vazhdueshme me Fondin e Kompensimit, duke mos shlyer asnjëherë plotësisht detyrimet objekt të tij, në kundërshtim me nenet 21, 29, 30, 31 të Ligjit nr. 10076/2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.
- Për rrjedhojë, Byroja nuk ka realizuar historikisht dëmshpërblimet e plota për përfituesit, duke shkelur nenin 42, pika 6, të Ligjit nr. 10076/2009.
- Autoriteti ka miratuar tradicionalisht vlerën e Fondit të Kompensimit që ka propozuar vetë Byroja pa ndërmarrë analiza të situatës, si dhe nuk ka kryer inspektime të mjaftueshme mbi saktësinë e raportimit dhe ecurinë e pagesave të bëra nga shoqëritë deri në vitin 2017.



- Databaza e BSHS-së nuk ka qenë e përditësuar në mënyrë korrekte dhe rigoroze sa i përket detyrimeve objekt FK dhe vlera e dëmeve të papaguara në procese gjyqësore është llogaritur 0.

***Për sa më sipër, rekomandojmë:***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të vijojë kryerjen e inspektimeve tematike periodike, me objekt Fondin e Kompensimit pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe shoqërive të sigurimit, në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e shlyerjes së detyrimeve.

***Në vijimësi***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të verifikojë, me anë të kryerjes së analizave të nevojshme dhe të inspektimeve vit pas viti, saktësinë e të dhënave të raportuara nga Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe, në veçanti, propozimet për shumën e Fondit të Kompensimit.

***Në vijimësi***

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pas ndryshimeve të nevojshme ligjore në Ligjin nr. 10076/2009 “Për sigurimin e deyrueshëm në sektorin e transportit” dhe në bashkëpunim me Byronë Shqiptare të Sigurimit, të rishikojë Statutin e Byrosë duke parashikuar që shumicën e anëtarëve në organet drejtuese ta ketë AMF-ja, si rregullatore dhe mbikëqyrëse e këtij tregu, me qëllim mosmarrjen e vendimeve në konflikt interesi nga ana e kompanive dhe shlyerjen e plotë të pagesave objekt të Fondit të Kompensimit.

***Pas miratimit të projekt-ligjit përkatës***

**VIII. Për pyetjen: “A ka marrë masa AMF për zgjidhjen e ngërçit me Fondin e Kompensimit?”**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, referuar kërkesës së Komisionit për Ekonominë dhe Financat për raportimin 2-javor mbi ecurinë e pagesave të Fondit të Kompensimit dhe referuar raportimeve ditore të shoqërive të sigurimit deri më datë 7 nëntor 2018, ka paraqitur informacionin përkatës. Situata e pagesave të FK deri më datë 7 Nëntor 2018, i referohet totalit të vlerës së FK për pagesë në shumën 1.105.266.923 lekë, të miratuar sipas Vendimeve të Bordit nr. 217, datë 28.12.2017, si dhe nr. 155, datë 30.07.2018.

**Tab. 3:** Ecuria e pagesave deri më datë 7 Nëntor 2018, referuar totalit të Fondit të Kompensimit të vitit 2018

Shoqëria e sigurimit	Detyrim Fond Kompesimi për pagesë 2018 sipas VB 217, 28.12.2017	Fond shtesë sipas VB 155, 30.07.2018	Total Fondi i Kompensimit për pagesë për vitin 2018	Dëme të paguara TOTAL	Ecuria e pagesave në %
Insig	96.062.709	16.760.888	112.823.597	85.416.391	75,71%
SIVIG	134.388.600	28.911.122	163.299.722	128.296.871	78,57%



<b>SIGAL UGA</b>	169.182.377	38.725.183	207.907.560	219.326.392	105,49%
<b>Atlantik</b>	72.461.908	16.041.672	88.503.580	71.722.331	81,04%
<b>Intersig VIG</b>	91.409.090	21.609.567	113.018.657	93.289.726	82,54%
<b>Albsig</b>	94.332.393	18.982.138	113.314.531	60.902.230	53,75%
<b>Eurosig</b>	191.094.140	26.293.497	217.387.637	102.950.651	47,36%
<b>Ansigt</b>	74.423.542	14.588.099	89.011.641	66.305.398	74,49%
<b>TOTAL</b>	<b>923.354.759</b>	<b>181.912.166</b>	<b>1.105.266.923</b>	<b>828.209.990</b>	<b>74,93%</b>

Sikurse rezulton gjatë periudhës 1 Janar 2018 – 7 Nëntor 2018, vlera e paguar për FK është **828.209.990 lekë**, pra, **74,93%** e totalit të detyrimit të përcaktuar nga VB. Nëse e krahasojmë situatën aktuale me atë të datës 10 Shtator 2018<sup>10</sup>, vërejmë se janë paguar 287.058.399 lekë më shumë, me një rritje të pagesave nga ana e shoqërive të sigurimit me 16%. Rrjedhimisht, mbetet ende shuma prej **277.056.933 lekësh** ose rreth **¼ e FK** për t'u paguar nga kompanitë në favor të qytetarëve. Trendi i pagesave është rritës dhe AMF është dakordësuar me kompanitë që FK të shlyhet i gjithi brenda muajit Janar 2019, me përjashtim të pagesave objekt procesesh gjyqësore.

Ky objektiv duket i vështirë për t'u arritur, mirëpo ecuria e muajve të fundit tregon për një punë të mirë të Autoritetit në lidhje me këtë aspekt, pas rekomandimeve edhe të Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Ecuria e pagesave sipas vendimeve të mësipërme duhet shqyrtuar çdo muaj nga Bordi i AMF-së. Bordi duhet të ndëshkojë çdo rast vonese apo abuzimi në mënyrë që Fondi të mos bllokohet sërish për shkak të praktikës *laissez-faire* që ka sjellë edhe këtë problematikë.

#### Gjetje:

- Deri më datë 07.11.2018, kompanitë e sigurimit kanë paguar për llogari të Fondit të Kompensimit një shumë prej **828.209.990 lekësh**, nga detyrimi total prej **1.105.266.923 lekësh** miratuar me Vendim Bordi nr. 155, datë 30.07.2018; pra, është paguar 74,93% e shumës FK dhe mbetet ende për t'u paguar shuma prej **277.056.933 lekësh** ose rreth **¼ e FK**.
- Byroja Shqiptare e Sigurimit nuk ka arkëtuar 60% të vlerës së gjobave që u janë vënë mjeteve motorike të pasiguruara, në kundërshtim me nenin 45, pika 3/c e Ligjit nr. 10076/2009 "Për sigurimin e deyrueshëm në sektorin e transportit". Kjo ka ndodhur për arsye të mospërputhjes së këtij ligji me Kodin Rrugor të RSH.
- Faqja *web* e Byrosë Shqiptare të Sigurimit është e papërditësuar dhe nuk siguron transparencën e duhur për publikun dhe informacione mbi pagesat objekt Fondi Kompensimi. Seksioni i lajmeve është përditësuar për herë të fundit në vitin 2010. BSHS-ja nuk ka zbatuar pikën 1.9 të Vendimit të Bordit të AMF-së me nr. prot. 435, datë 10.02.2017, sa i takon përmirësimin të faqes zyrtare elektronike.

#### Për sa më sipër, rekomandojmë:

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë të gjitha masat përkatëse për të vijuar monitorimin e shlyerjes së plotë të detyrimeve të prapambetura objekt Fondi Kompensimi nga ana e shoqërive të sigurimit, sikurse është dakordësuar me to dhe

<sup>10</sup> Tab. 3 e Raportit të Auditimit: data e raportimit të AMF-së mbi FK gjatë fazës studimore të auditimit.





në vijim të angazhimit përpara Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

**Brenda muajit Janar 2019**

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat e nevojshme që Byroja Shqiptare e Sigurimit të përditësojë faqen zyrtare elektronike me të dhënat më të fundit të verifikuara sa i përket Fondit të Kompensimit dhe të bëjë transparencë për qytetarët.

**Brenda muajit Shkurt 2019**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

**Grupi i Auditimit**

Dorel BALLIU

Brenton KOTORRI

Miranda MISINI

Zef PREÇI

(ekspert i jashtëm)

---

**Bujar LESKAJ**

  
**KRYETAR**

Konceptoi: D. Balliu

Miratoi: R. Muça

